



# **TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE**

**Tremujori IV 2023**

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore**

## Përmbajtje

I. HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME .....	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE.....	5
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare.....	5
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare .....	8
3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare.....	9
4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë .....	11
5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë.....	11

## I. HYRJJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për tremujorin e katërt të vitit 2023, si edhe krahasimet me tremujorin e tretë të vitit 2023 dhe me tremujorin e katërt të vitit 2022, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al), në seksionin “Statistika rreth AKEP” - “Shërbimet Postare”.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

## II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e katërt të vitit 2023 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP për periudhën e raportimit janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (23 subjekte):**
  1. Air Cargo Service sh.p.k. (A.C.S.)
  2. Albanian Delivery Express sh.p.k.
  3. ALOPOST sh.p.k.
  4. BIPEX sh.p.k.
  5. Blendi Dokollari –Person Fizik (Flash Delivery Albania)
  6. DHL International (Albania) sh.p.k.
  7. Elite Post sh.p.k.
  8. EXPRESS ALB 24 sh.p.k.
  9. GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.)
  10. GENIKI TAXYDROMIKI ALB sh.p.k
  11. Greenposta shpk
  12. INTEX COURIER sh.p.k.
  13. IPOST sh.p.k.
  14. Milsped Albania sh.p.k.
  15. Mr. COURIER sh.p.k.
  16. POSTA JONË sh.p.k.
  17. POSTMAN sh.p.k

18. T.N.T Express Albania sh.p.k.
19. Top Post sh.p.k.
20. Ultra C.E.P. sh.p.k.
21. Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex)
22. United Transport sh.p.k. (Uni Trans)
23. Youth Albania Professional Services (YAPS);

Gjatë periudhës, nga tremujori i tretë i vitit 2023 deri në tremujorin e katërt të vitit 2023, ka 2 subjekte të çregjistruar për ofrimin e shërbimeve postare dhe kanë raportuar të dhënat statistikore 23 subjekte<sup>1</sup>.

Posta Shqiptare me VKD Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

---

<sup>1</sup> Ofrues të shërbimeve postare që kanë raportuar të dhënat statistikore në AKEP deri më datë 20.01.2024

### III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara nga ofruesit e shërbimeve postare përbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres.

#### 1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023 rezultojnë 6,019,463 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të dhëna në mënyrë më të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

**Tabela 1.1:** Të dhëna përmblledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara

Shërbime postare të ofruara		T4_2022	T1_2023	T2_2023	T3_2023	T4_2023	Ndryshim T4_2023/ T3_2023	Ndryshim T4_2023/T4_2022
<b>1</b>	<b>Shërbim Universal Postar</b>							
1.1	Postë brenda vendit	5,906,952	5,351,099	3,679,866	4,098,479	4,522,704	10%	-23%
1.2	Postë ndërkombëtare	186,079	184,390	188,482	186,888	183,248	-2%	-2%
<b>1.3</b>	<b>Totali 1.1+1.2</b>	<b>6,093,031</b>	<b>5,535,489</b>	<b>3,868,348</b>	<b>4,285,367</b>	<b>4,705,952</b>	<b>10%</b>	<b>-23%</b>
<b>2</b>	<b>Shërbim jouniversal postar</b>							
2.1	Postë brenda vendit	101,500	92,252	164,019	72,173	73,570	2%	-28%
2.2	Postë ndërkombëtare	449	146	631	532	574	8%	28%
2.3	<b>Totali 2.1+2.2</b>	<b>101,949</b>	<b>92,398</b>	<b>164,650</b>	<b>72,705</b>	<b>74,144</b>	<b>2%</b>	<b>-27%</b>
<b>3</b>	<b>Shërbim ekspres</b>							
3.1	Ekspres brenda vendit	124,731	126,129	126,802	129,033	109,818	-15%	-12%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	3,411	3,883	3,954	1,329	3,234	143%	-5%
3.3	<b>Totali 3.1+3.2</b>	<b>128,142</b>	<b>130,012</b>	<b>130,756</b>	<b>130,362</b>	<b>113,052</b>	<b>-13%</b>	<b>-12%</b>
<b>4</b>	<b>Shërbim JoUniversal Postar</b>							
4.1	Postë brenda vendit	205,826	196,289	199,271	153,457	154,541	1%	-25%
4.2	Postë ndërkombëtare	4,429	2,819	4,295	4,304	23,192	438.8%	424%
4.3	<b>Totali 4.1+4.2</b>	<b>210,255</b>	<b>199,108</b>	<b>203,566</b>	<b>157,761</b>	<b>177,733</b>	<b>13%</b>	<b>-15%</b>
<b>5</b>	<b>Shërbim ekspres</b>							
5.1	Ekspres brenda vendit	779,474	712,332	679,269	689,710	825,031	20%	6%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	93,927	63,387	104,757	119,519	123,551	3%	32%
5.3	<b>Totali 5.1+5.2</b>	<b>873,401</b>	<b>775,719</b>	<b>784,026</b>	<b>809,229</b>	<b>948,582</b>	<b>17%</b>	<b>9%</b>
<b>6</b>	<b>Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3</b>	<b>7,406,778</b>	<b>6,732,726</b>	<b>5,151,346</b>	<b>5,455,424</b>	<b>6,019,463</b>	<b>10%</b>	<b>-19%</b>

Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Në mënyrë të përmblledhur në vijim paraqiten disa nga zhvillimet kryesore në këtë treg:

### **Posta Shqiptare (Ofrues i Shërbimit Universal)**

- ✓ **Shërbim universal postar.** Ky zë në total ka pësuar rënie në masën 23% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës dhe rritje në masën 10% krahasuar me 3 mujorin e mëparshëm T3 2023,. Edhe zëri **Postë brenda vendit** ka pasur një rënie krahasuar si me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm në masën 23%, dhe një rritje në masën 10% në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm, ndërsa zëri **Postë Ndërkombëtare** ka një rënie në nivelin 2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 3-mujorin e mëparshëm T3 2023.
- ✓ **Shërbimi Jo universal postar.** Ky zë në total ka pësuar një rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në nivelin 27% dhe një rritje në nivelin 2% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T3 2023. Në të njëjtat nivele është dhe **Postë brenda vendit**. Ndërsa zëri **Postë ndërkombëtare** ka një rritje me 28% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe me 8% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T3 2023.
- ✓ **Shërbimi Ekspres** Ky zë në total ka pësuar rënie nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 12% dhe me 13% në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T3 2023. Edhe shërbimi **Ekspres brenda vendit** ka pasur rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 12% dhe në masën 15% në krahasim me 3 mujorin e mëparshëm T3 2023, ndërkohë që zëri **Ekspres Ndërkombëtar** ka pësuar rënie krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 5%, dhe një rritje të konsiderueshme në masën 143% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T3 2023.

### **Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare**


- ✓ **Shërbimi Jo Universal Postar.** Ky zë ka një rritje në 3-mujorin e IV 2023 në krahasim me 3-mujorin e III të 2023 në masën 13% dhe një rënie në masën 15% në krahasim me 3-mujorin IV të vitit të kaluar. Edhe zëri **Postë brenda vendit** ka pasur rritje në krahasim me 3-mujorin e III të 2023 në masën 1% dhe një rënie në masën 25% krahasuar me 3-mujorin IV të vitit të kaluar. Ndërsa zëri **Postë ndërkombëtare** ka pasur një rritje mjaft të konsiderueshme në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T3 2023 në masën 439% dhe 424% në krahasim me 3-mujorin IV të vitit të kaluar.
- ✓ **Shërbimi ekspres.** Ky zë ka pasur rritje në totalin e tij krahasuar me 3-mujorin e kaluar T3 2023 në masën 17%, dhe në masen 9% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Zëri i shërbimit **Ekspres brenda vendit** ka një rritje në masën 20% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm dhe në masën 6% krahasuar me vitin e kaluar. Zëri i shërbimit **Ekspres ndërkombëtar** ka pasur rritje krahasuar si me 3-mujorin e mëparshëm T3 2023 ashtu edhe me të njëjtën periudhë të një viti më parë, përkatësisht në masat 3% dhe 32%.

**Tabela 1.2:** Totali i objekteve postare-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T4 2023

Totali i objekteve postare		
	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	4,893,148	81%
<i>Of. e tjerë</i>	1,126,315	19%
<b>Totali</b>	<b>6,019,463</b>	<b>100%</b>

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

**Grafiku 1.1:** Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, shikojmë një rritje në objektet postare në T4\_2023 krahasuar me T3\_2023 si për Postën Shqiptare ashtu edhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare. Krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë kemi një rënie të totalit të objekteve postare për Postën Shqiptare dhe rritje për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.


**Tabela 1.3:** Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T4\_2023

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
4,705,952	251,877	1,061,634	6,019,463
78%	4%	18%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e raportuara rezultojn se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me 78%, ndjekur nga shërbimi ekspres me 18% dhe shërbimi jo universal 4 %.

**Grafiku 1.2:** Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar. Nga krahasimi i periudhës T4\_2023 me periudhën T3\_2023 vërehet që kemi një rritje në masën 10% në volumin total të shërbimeve postare. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë evidentohet një rënie në masën 19%.

## 2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

**Tabela 1.4:** Shërbimi Universal Postar T4 2023


Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	4,522,704
Postë ndërkombëtare	183,248
<b>Totali</b>	<b>4,705,952</b>

Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga të dhënat e tabelës 1.4 për T4 2023, për sa i përket shërbimit Universal Postar, vihet re se Posta Shqiptare realizoi gjithsej 4,705,952 objekte, nga të cilat posta brenda vendit zë 96% të objekteve postare dhe posta ndërkombëtare zë 4% të objekteve postare. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 3,736,551 shërbime për objekte të thjeshta dhe 786,153 shërbime për objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 37,197 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 146,051 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.



**Grafiku 1.3:** Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 muajor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga grafiku i mësipërm, shikohet një rritje e shërbimit universal postar në T4\_2023 krahasuar me T3\_2023, me 10%.

### 3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare

Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:


**Tabela 1.5:** Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Sh

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut T_4 2023	Pjesa tregut T_4 2022
Shërbim universal postar	4,705,952	96.2%	96.4%
Shërbim jo universal postar	74,144	1.5%	1.6%
Shërbim ekspres	113,052	2.3%	2.0%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 96.2%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 2.3% dhe nga shërbimi jo universal postar 1.5%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi një rënie të vogël Shërbimit jo universal postar dhe rritje të Shërbimit ekspres.

**Grafiku 1.4:** Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare, ku vihet re një rritje e shërbimit universal dhe e atij jo universal dhe rënie dhe për shërbimin ekspres në T4\_2023 krahasuar me T3\_2023.

#### 4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

**Tabela 1.6:** Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T4_2023	Pjesë tregu T4_2022
P.Sh	74,144	29%	33%
Of. e tjerë	177,733	71%	67%
<b>Totali</b>	<b>251,877</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

**Grafiku 1.5:** Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në T4\_2023 krahasuar me T3\_2023 kanë pasur rritje në total në masën 9% ku vërehet një rritje prej 2% për Postën Shqiptare, dhe me 13% për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë T4 2023 përbëhet nga 228,111 objekte brenda vendit dhe 23,766 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.

### 5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2023, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2022, mbi baza tremujore.

**Tabela 1.7:** Shërbimi ekspres-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për T4\_2023

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T4_2023	Pjesë tregu T4_2022
P. Shqiptare	113,052	11%	13%
Of. e tjerë	948,582	89%	87%
Totali	1,061,634	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

**Grafik 1.6:** Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Shërbimi ekspres, gjatë T4\_2023 ka pësuar rritje në krahasim me T3\_2023 në masën 13% dhe me 6% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Duhet theksuar se ndikimin në këtë rritje e kanë Ofruesit e tjerë, ndërsa PSH ka pasur rënie.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë së bashku është në vlerën 934,849 objekte postare ose 88% e totalit të këtij shërbimi, ndërsa shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 126,785 objekte postare ose 12% e totalit të këtij shërbimi për periudhën raportuese.

Për sa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri është në vlerën 98,888 objekte dhe sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit është në vlerën 27,897 objekte.